

# Bebeve u pëlqejnë librat

Një udhëzues për të rriturit



Catherine and Laurence Anholt

# Bebeve u pëlqejnë librat





Libra? Për bebet?

Ju s'keni mësuar të  
lexoni ende!

Jo, por ne kënaqemi duke  
parë figurat si dhe duke ju  
**DËGJUAR** ju.



Nuk kam shumë kohë sot – kam  
gjëra me rëndësi për të bërë.



Po hë mor babi, s'ka gjë më  
me rëndësi sesa koha që  
kalojmë bashkë.

Librat janë pér t'u lexuar  
SË BASHKU.





Ç'është e vërteta... unë  
nuk lexoj dhe aq mirë  
me zë.

S'ka problem. Mua më pëlqen  
tingulli i zërit tënd... dhe ti i tregon  
shumë bukur tregimet.

Hë pra... thjesht më  
fol për figurat.




Mua më pëlqen të dëgjoj  
dhe vëllain tim  
kur lexon.

# KU ËSHTË VENDI MË I MIRË PËR TË LEXUAR NJË LIBËR SË BASHKU?



Në vaskë, në autobus ose në krevat  
Në dush, në dyqan ose në barakë  
Në oturak, në karrocë dhe në lulishte  
Me të zbardhur dita ose kur erret



Në tren ose në trungun e një peme  
Në rrugë ose në rërë buzë detit  
Në makinë, në krevat apo në karrige  
Ulu dhe shfleto një libër KUDO  
që të jesh!

Por cilët libra janë më të përshtatshëm për bebet?



Librat me kafshë



Librat me vjersha për fëmijët e vegjël



Librat me figura kartoni që dalin nga faqet



Librat me fletë kartoni të fortë



Librat për të mësuar numërimin



Librat për të qeshur



Librat për në vaskë



Librat me përralla



Librat me këngë




Librat për kohën  
e gjumit



Çfarëdolloj libri!




Librat janë për bebet  
por edhe për JU,  
gjyshen dhe gjyshin  
dhe  
tezen e mamit, Su



nipërit dhe komshinjtë,  
Muhamed i dhe Hju  
vëllezërit dhe nënët  
dhe... hej!

BABIN GJITHASHTU!



Ku mund të gjej libra  
për bebin tim?





Është shumë e vërtetë.  
Bebet i duan librat... po këshfu  
dhe ne.

Kam dëgjuar që bebet që fillojnë me  
libra mësojnë të lexojnë më shpejt,

dhe kanë mundësi më të  
mira për të dalë me sukses  
në shkollë.


Neve na pëlqen  
të shkojmë në  
bibliotekë.

PRA LEXONI LIBRA SË BASHKU ME BEBET  
DHE NA JEPNI TË GJITHËVE NJË FILLIM  
TË SHKËLQYER!

Ka kohë për libra dhe për  
televizor gjithashtu.

Unë mund të mësoj  
të hap faqet.

Nuk është  
asnijëherë shumë  
shpejt për të  
filluar.






Bookstart është një partneritet midis palëve shtetërore dhe publike, i administruar nga Booktrust, një shoqatë bamirëse kombëtare e pavarur e cila nxit njerëzit e të gjitha grupmoshave dhe kulturave të zbulojnë dhe të kënaqen me leximin.

Booktrust organizon projekte për leximin dhe shkrimin, administron disa çmime dhe ofron informacion për mijëra libra në faqet e internetit.



Bookstart financohet nga Departamenti për Fëmijët, Familjet dhe Shkollat në Angli; Administratat Rajonale si dhe sponsorizimi bujar i botuesve dhe shitësve të librave për fëmijë.



Për më shumë informacion për programin kombëtar Bookstart viziton faqen në internet [www.bookstart.org.uk](http://www.bookstart.org.uk)

Për më shumë informacion për Booktrust viziton [www.booktrust.org.uk](http://www.booktrust.org.uk)




*Ilustrimet dhe fjalët nga Catherine dhe Laurence Anholt.*  
Anholt janë një nga grupet autor-artist më të suksesshëm të botës, të cilët kanë bashkëpunuar për më shumë se 90 libra të botuar për fëmijë që kanë fituar çmime. Gjeni më shumë tek [www.anholt.co.uk](http://www.anholt.co.uk)



*Vizatimet nga Orchard Books*

**booktrust**



ORCHARD BOOKS